

VENDIM
Nr.731, datë 1.7.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.818, DATË 29.11.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE «PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË
PËRDORIM, TË KOMUNËS GOLEM TË QARKUT TË FIERIT»

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.818, datë 29.11.2007 të Këshillit të Ministrave, nga prona nr.243, sipërfaqja 1018 (një mijë e tetëmbëdhjetë) m² t’i kalojë në pronësi komunës Golem të qarkut të Fierit, si truall dhe sipërfaqe funksionale e ndërtesës, ku ushtron veprimtarinë administrative, sipas formularit nr.1 dhe planvendosjes, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Komunës Golem i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë apo t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Golem për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULARI PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTESHME SHETERORE

(Per inventarizimin e Pronave te Vecanta)

Komuna Golem Fusha e perdorimit te prones:Infrastrukture dhe Sherbim Publik										Identifikoi : Fatime Velçani (Specialiste) (Emer,mbiemer ,pozicioni zyrtar) Supervizoi Qazim Koçi (Pergj.i Kadastrës) (Emer ,mbiemer ,pozicioni zyrtar) Aprovoi Beqir Sulovari Kryetar i Komunes Golem (Emer,mbiemer ,pozicioni zyrtar,tel,firma.vula)			
A				B			C						
Nr	Zona kadastrale indeks hartes	Nr. Pasuris	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones m2	Nga Sip. Totale Sa Nderteses m2	Funksioni per te cilin perdoresh prona	Institucioni/ Enti me pergjegjesi administrative	Institucion Enti perdoresh Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (shenime te vecanta)			
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11			
1	8571	19/1	Truall	Truall i Nderteses se Zyrrave te Komunes Golem	1018 m2		Administrata	K Golem	K Golem				

[illegible]

[Signature]